



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 18 datë 22 / 09 /2017

**“ Për Miratimin e “Lejes për Përdorim Uji Teknologjik”,
Subjekti “ERI”sh.p.k**

Në mbështetje të neneve 7 pika 2 , nenit 50, 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” , vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe kërkesës së subjektit “**ERI**” sh.p.k,me administrator z. Gjon Lufi, me propozim te A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat;**

V e n d o s i:

1. Miratimin e “**Lejes për Përdorim Uji Teknologjik**”, Pus shpimi ekzistues sipas studimit të paraqitur nga subjekti “**ERI**” shpk, me administrator z. Gjon Lufi me këto të dhëna:
-Vendndodhja e pus-shpimit , **Mamurras, Kurbin**
-Prurja mesatare: 2 l/s
-Sasia e ujit për përdorim: 0.3 l/s
-**Koordinatat e burimit ujor:**

Kordinatat		Thellësia
X	Y	
46 05 370	43 89 544	14 m

2. Ngarkohet A.B.U. Mat për zbatimin e këtij vendimi .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT
Ast NIKOLLA



KRYETARI I K.B.U. MAT
Eduard NDRECA

